



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2024:103551  
Datë: 24.05.2024  
Numri i dokumentit: 05732815  
**C.nr.1912/2024**

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN– **Departamenti i përgjithshëm– Divizioni civil**, me gjyqtarin Baki Shigjeqi, duke vendosur në çështjen juridiko- kontestimore të paditësit B.A. me numër personal .... me vendbanim në fshatin ....., komuna e Prizrenit, të cilin me autorizim e përfaqëson av. V.K. nga Prizreni, kundër të paditurës Q.K., M.F., Punës dhe Transfereve- Departamenti i Pensioneve me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore – Prishtinë, për shkak të kompensimit të dëmit mbi bazën të inflacionit, vlera e deklaruar e kontestit njëqindedyzet euro (140.00 €), jashtë seance, me datë 24.05.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**I. KONSTATOHET** së është tërhequr padia me shenjë C.nr.1912/2024 e datës 03.04.2024, e paditësit B.A. nga fshati ....., komuna e Prizrenit, të cilin me autorizim e përfaqëson av. V.K. nga Prizreni, kundër të paditurës Q.K., M.F., Punës dhe Transfereve- Departamenti i Pensioneve me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore - Prishtinë, për çështjen juridike me objekt kontesti kompensim i dëmit mbi bazën e inflacionit.

**A r s y e t i m**

Paditësi B.A. nga fshati ....., komuna e Prizrenit, përmes të autorizuarit të tij av. V.K. nga Prizreni, ka ushtruar padi në këtë gjykatë me datë 03.04.2024, kundër të paditurës Q.K., M.F., Punës dhe Transfereve- Departamenti i Pensioneve me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore - Prishtinë, për shkak të kompensimit të dëmit mbi bazën të inflacionit, vlera e deklaruar e kontestit njëqindedyzet euro (140.00 €).

I autorizuari i paditësit me parashtrësën e datë 05.04.2024, e ka njoftuar gjykatën se në këtë çështje juridike kontestuese, në mungesë të interesit juridike për vazhdimin e ndjekjes së çështjes përmes Gjykatës e TËRHEQ PADINË.

Gjykata në kuptim të dispozitave nga neni 261 par.1 e lidhur me nenin 387 par.1 pika c, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si ne dispozitiv të këtij vendimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL**  
2024:103551, 24.05.2024

**Gj y q t a r i,**

**Baki Shigjeqi**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi, në kuptim të nenin 261 par.4 të LPK-së, nuk është e lejuar ankesa.